

Të nderuar pjesëmarrës

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik,

Shkëlqesia Juaj, ambasador i Japonisë dhe ambasador i Spanjës

Të nderuar akademikë, të nderuar kolegë.

Rektorë të Universiteteve e shkollave të larta në Shqipëri, pedagogë, profesorë, punonjës kërkimor-shkencorë.

Së pari Ju falënderoj për prezencën tuaj, për vlerësimin e mbështetjen.

Më lejoni t'i urojmë së bashku, rrugë të mbarë e suksese, njësisë së re NanoAlb, që ngrihet pranë Akademisë së Shkencave me iniciativën e akademik Arben Merkoçit e të Akademisë si dhe me nxitjen, përkrahjen e shumë kërkuesve në këtë fushë, këtu tek ne.

Njësia, siç është bërë tashmë e njohur, aktualisht përbëhet nga akad. Arben Merkoçi, drejtues i saj, prof. Majlinda Vasjari (Universiteti i Tiranës) e prof. Kledi Xhaxhiu anëtarë, si dhe një rreth i gjerë bashkëpunëtorësh.

Pse ngrihet për herë të parë një njësi e tillë? Përse tani e pse në fushën e nanoteknologjisë.

Ngrihet tani për faktin e thjeshtë, se reforma e re, rishtazi mundëson e lejon, Akademinë e Shkencave të ngrejë pranë saj njësi të kërkim-studimit afatshkurtra.

Ligji i ri e Statuti ynë, tregojnë qartë se si ngrihen këto njësi, për ç'qëllim dhe si funksionojnë ato. Pika kryesore e debatit për reformën në Akademinë e Shkencave, e vetmja çështje që në fakt meritonte debat, ishte në se Akademia e Shkencave do të vazhdonte të mbetej një institucion honorifik apo pranë saj duhet të funksionojnë edhe një numër institutesh kërkimore të fushave të ndryshme, siç ishte përvoja e para 2007. Fatkeqësisht ky debat, fillimisht e kryesisht nuk u

përqendrua tek efikasiteti dhe përparësitë e njërit apo tjetrit model, por ai u thjeshtëzua në faktin e argumentin e vetëm se modeli me institute është një model i trashëguar nga sistemi monist e si i tillë duhej shpërbërë.

Ndërkohë legjislati i çdo periudhe për Akademinë e Shkencave, para e pas reformës 2007 parashikonte e kërkonte nga Akademia e Shkencave të luajë një rol aktiv në kërkimin shkencor, të nxisë e të promovojë këtë kërkim, t'i rekomandojë Këshillit të Ministrave hapjen e njësive të reja, të kërkimit, të koordinojë kërkimin shkencor në vend, mirëpo për të kryer këtë mision e këto funksione patjetër që Akademisë së Shkencave, i duhen edhe mekanizmat e organizimit të nevojshëm pasi këto s'mund të realizohen as me deklarata as me opinione apo rezoluta të Asamblesë.

Edhe zhvillimi i organizimit akademik në botë sot e ka tejkaluar e nuk respekton më kufirin ndarës në model lindor a perëndimor, sipas ndarjes së shteteve në të lindjes e perëndimit.

Përvoja e shumë vendeve perëndimore tregon se modeli i Akademisë së Shkencave me një numër institutesh elitare pranë saj, është një model funksional, i suksesshëm se ky model lehtëson, mundëson dhe rrit përgjegjësinë e Akademisë për të qenë vërtet qendra kryesore e kërkimit akademik në vend, jo vetëm nëpërmjet cilësisë e punës së anëtarëve të saj, por veçanërisht nëpërmjet punës së institucioneve kërkimore pranë saj. Në çdo rast ky model mundëson që Akademia e Shkencave të luajë një rol koordinues në kërkim e të jetë në pararojë të tij si dhe i jep mundësinë Akademisë të paraqesë në çdo kohë institucioneve politik-bërëse për shkencën, raporte të plota për nivelin e kërkimit e të shkencës në vend dhe problematikën e tyre. Veçanërisht i domosdoshëm bëhet ky rol në një vend ku ende mungon një qendër kombëtare e koordinimit të shkencës dhe përvoja jonë e këtyre 12 vjetëve bindi gjithkënd për efektet negative të reformës së 2007 që shveshën artificialisht Akademinë e Shkencave nga institucionet kërkimore.

Veçanërisht opinioni e kuptoi këtë; kuptoi rëndësinë dhe vlerën e Instituteve gjeologjike, sizmologjike, etj., të punimeve të tyre e dëmin për nënvleftësimin e tyre; me rastin e tërmeteve të shtatorit, nëntorit, Akademia vlerësoj se rolin e saj mund ta kryejnë nëpërmjet ngritjes së njësive si fazë të parë. Meqenëse disa,

rikthimin me institute, e quanin rikthim mbrapa, ndonëse kur ngatërron rrugën së pari është mirë të kthehesh mbrapa, ASH vlerësoi se mund të kryejë rolin e saj edhe nëpërmjet njësive të kërkimit si fillim, si NanoAlb. Kjo bëhet jo vetëm si një hap më i kujdesshëm por edhe se qëllimi ynë nuk është kthimi a ngritja e një instituti ekzistues apo të ri pranë ASH, por nxitja e kërkimit në fushat parësore dhe ngritja e njësive apo strukturave përkatëse si pjesë e sistemit tonë kërkimor, pavarësisht nga vartësia.

Pikërisht këtë kërkojmë të realizojmë me njësinë e re të NanoAlb. E cila së pari ka si mision të evidentojë kërkuesit e kësaj fushe tek ne, nivelin e tyre, njësitë ekzistuese, si departamente etj., që kanë për objekt të punës së tyre: nano-shkencën e nano-teknologjinë.

Vlerësojmë e përgëzojmë faktin se ende pa u ngritur mirë njësia, ajo ka krijuar tashmë një rreth bashkëpunëtorësh mjaft premtues, prezente në sallë, Ata përfaqësojnë njësitë kryesore të kërkimit në këto fusha pranë IAL në Shqipëri, Kosovë etj. e kjo është bërë e mundur pasi prof. Merkoçi ka vite që përpiket ta kryejë këtë rol e jo pa sukses.

Nano teknologji - nano shkencë, përbëjnë një ndër 4 fushat e së ardhmes. Hyjnë në shkencat që po revolucionarizojnë kërkimin e teknologjitë në shumë disiplina, e përballë këtij zhvillimi të vrullshëm Shqipëria është pak e përgatitur, prapambetja është e madhe, por edhe shpresa gjithashtu, pasi edhe në këto periudha jo të favorshme për shkencën e kërkimin tek ne, për Akademinë e Shkencave, për Institucionet e Arsimit të Lartë, për arsimin në tërësi, përsëri shohim se ka mjaft kërkues të pasionuar që duhen mbështetur, duhen nxitur, duhen motivuar, që i duhen krijuar kushtet, për të rritur bashkëpunimin midis tyre, ashtu siç ka mjaft potenciale të nivelit ndërkombëtar, ndër shqiptarët, që studiojnë apo punojnë jashtë vendit, e një ndër ta, për fatin tonë të mirë është edhe akademik Merkoçi. Vlerësoj e besoj se njësisë nuk do t'i mungojë ndihma e bashkëpunimi me simotra në Evropë e më gjerë. Ajo tashmë ka krijuar lidhje shumë të mira në Spanjë e Japoni.

Shkalla e suksesit të saj do të jetë zgjerimi i këtij bashkëpunimi nëpërmjet projekteve të përbashkëta. Boshllëku ynë në këto fusha është një mundësi por

edhe një favor, pasi mundësitë e nevojat për aplikim të dijeve e teknologjive të reja është më e madhe, shkalla e suksesit edhe e efikasitetit të projekteve të caktuara është më i mundshëm.

Së fundi, dëshiroj të theksoj, se njësia është ngritur pranë Akademisë së Shkencave, por ashtu siç ka filluar, e në tërë veprimtarinë e riorganizimit e mëpastajmë të saj, ajo do të jetë produkt i përbashkët i Akademisë së Shkencave, me IAL, Institutet, Qendrat përkatëse ku punohet e flitet për Nano Teknologjinë. Dy anëtarët e saj janë punonjës të UT, e ne falënderojmë Universitetin për përg. e tyre e për ofrimin e këtyre asetëve me vlerë për njësinë (ndonëse të marë pa leje). Qëllimi i ngritjes së kësaj njësie të re, që do të pasohet me njësitë e tjera në fusha po aq me perspektivë si ajo e bioteknologjisë se bioshkencës, teknologjitë e informacionit e inteligjenca artificiale, është koordinimi i kërkimit e jo monopolizimi i kërkimit prej ASH.

Suksese njësisë, suksese në Tokio, suksese në tetor.

Akademik Skënder Gjinushi

*Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*

Tiranë, më 23 janar 2020